

## RAPORTI I PËRKOSSHËM

31 mars – 19 prill 2016

22 prill 2016

### I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Më 15 prill u shpallën zgjedhje të parakohshme parlamentare për 5 qershor. Partia kryesore opozitare dhe rreth 20 parti më të vogla kanë bërë të ditur synimin e tyre për bojkotim të zgjedhjeve, me argumentimin se nuk janë përmbushur kushtet kryesore të Marrëveshjes së Përzahinos, apo më saktësisht, pastrimi i listës zgjedhore, reformat në media dhe veçimi i aktiviteteve partiake nga ato shtetërore.
- Klima politike u përkeqësua pas 12 prillit, kur presidenti Ivanov fali të gjithë ata që ishin të dënuar, nën hetime, dhe të dyshuar lidhur me të ashtuquajturin “skandal të përgjimeve”. Gjithë partitë më të mëdha politike dënuan ashpër faljen dhe thirrën presidentin për të shfuqizuar vendimin e tij.
- Kodi Zgjedhor u ndryshua në thelb në nëntor të vitit 2015. Përderisa këto ndryshime trajtojnë shumicën e rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it dhe paraqesin përpjekje për përmirësim të Kodit, një numër i konsiderueshëm i bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë kumtuar se zbatimi i plotë i Kodit ka rëndësi të njëjtë. Disa të tjerë kanë thënë se ndryshimet e vonuara mund të kenë efekt negativ mbi kuptimin e palëve të përfshira në zgjedhje se si duhet t’i përmbushin detyrat e tyre.
- Në përbërjen e re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) janë tre ekspertë të pavarur, duke përfshirë këtu kryetarin dhe zëvendësin e tij, si dhe gjashtë anëtarë të emëruar nga partitë politike. Nga nëntë anëtarët e KSHZ-së, tre janë femra dhe tre janë shqiptarë etnikë.
- KSHZ vepron përbrenda një ambienti të tensionuar politik dhe seancat e tij të gjata tërheqin vëmendje të konsiderueshme të mediave. Më 15 prill, KSHZ votoi gatishmërinë për zbatim të “zgjedhjeve të ndershme dhe demokratike”. Kryetari i KSHZ-së dhe dy përfaqësuesit e opozitës refuzuan të marrin pjesë në këtë votim.
- Tani KSHZ është i vetmi që mban përgjegjësinë e mirëmbajtjes së listës zgjedhore. Në shkurt, KSHZ filloi procesin e pastrimit të listës zgjedhore, duke rishikuar bazat e ndryshme të të dhënave, si dhe duke zbatuar verifikime në terren. Bashkëbiseduesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë deklaruar se procesi është i ndërlikuar, sfidues për nga metodologjia dhe kërkon resurse të shumta.
- Përderisa korniza ligjore ofron trajtim të drejtë të partive politike nga mediat, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me përkeqësimin e lirisë së mediave për arsye të presionit politik dhe të pronarëve të mediave që ndërhyjnë në punën e gazetarëve. Ata gjithashtu kanë theksuar nevojën për ndryshime

thelbësore. Më 4 prill parlamenti hodhi poshtë projekt-ndryshimet në legjislacionin mbi mediat, të parashtruara nga koalicioni i organizatave të shoqërisë civile.

- Organizatat qytetare për vëzhgim MOST dhe CIVIL kanë shpallur qëllimin e tyre për të vëzhguar zgjedhjet. Më 5 prill, Policia Financiare filloi një hetim të aktiviteteve të MOST-it, ndërsa disa bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë vënë në pyetje kohën e zbatimit të këtij kërkimi.

## II. HYRJE

Pas marrjes së një ftese zyrtare dhe në bazë të rekomandimeve të Misionit për Vlerësimin e Nevojave të zbatuar nga 2 deri më 5 nëntor të vitit 2015, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), më 31 mars themeloi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ), për t'i vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 5 qershor.<sup>1</sup> MVZ drejtohet nga Ambasadori Jan Petersen dhe përbëhet nga 12 ekspertë të vendosur në Shkup dhe 24 vëzhgues afatgjatë u shpërndanë në mbarë vendin më 13 prill. Anëtarët e Misionit vijnë nga 21 shtete të ndryshme pjesëmarrëse të OSBE-së. Është kërkuar nga vendet pjesëmarrëse që të delegojnë 300 vëzhgues afatshkurtër për t'i vëzhguar veprimet në ditën e zgjedhjeve.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e fundit parlamentare janë zbatuar më 27 prill të vitit 2014 dhe kanë rezultuar me formimin e një koalicioni midis Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas me 61 deputetë, dhe Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) me 19 deputetë. Opozita përfshinte Lidhjen Social-Demokrate të Maqedonisë (LSDM) me 34 deputetë dhe Partinë Demokratike Shqiptare me 7 deputetë. Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) dhe Opsioni Qytetar për Maqedoninë (GROM) kishin nga një deputet.

Pas zgjedhjeve, LSDM refuzoi t'i merrte përsipër mandatet e saj dhe bojkotoi punën e parlamentit, me pretendimin se zgjedhjet nuk kanë qenë legjitime për shkak të mashtrimeve zgjedhore, frikësimeve dhe veçimit joadekuat të aktiviteteve shtetërore nga ato partiake. Kriza politike u thellua në shkurt të vitit 2015, ku regjistrimet inkriminuese të të ashtuquajturit “skandali i përgjimit” të cilat gjoja kanë përfshirë zyrtarë qeveritarë dhe publikë në korrupsion, mashtrime zgjedhore dhe abuzim të pushtetit, u lëshuan në publik dhe çuan drejt një vargu të protestave masive. Përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian ndihmuan një marrëveshje politike midis katër partive më të mëdha, që rezultoi me firmosjen e Marrëveshjes së Përzahinos më 2 qershor dhe Protokollit të saj më 15 korrik.<sup>2</sup> Marrëveshja ftonte për një “periudhë tranzicioni” që do të pasohej me zgjedhje parlamentare më 24 prill të vitit 2016. U themelua një qeveri e përkohshme më 11 nëntor, që u pasua me dorëheqjen e kryeministrit më 15 janar të vitit 2016.<sup>3</sup>

LSDM paralajmëroi në fillim të vitit 2016 se nuk do të merrte pjesë në zgjedhjet e shpallura për 24 prill, duke theksuar se nuk janë plotësuar kushtet kryesore të Marrëveshjes së Përzahinos, apo më saktësisht, pastrimi i listës zgjedhore, reformat në media dhe veçimi i aktiviteteve shtetërore nga ato partiake. Më 23 shkurt, ambasadorët e Bashkimit Evropian (BE) dhe të Shteteve të Bashkuara

<sup>1</sup> Shihni [raportet paraprake të OSBE/ODIHR](#) për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

<sup>2</sup> Shihni [Marrëveshjen e Përzahinos](#) dhe [Protokollin](#).

<sup>3</sup> Data e dorëheqjes ishte pjesë e Marrëveshjes së Përzahinos.

(SHB) lëshuan një vlerësim të përbashkët, duke ardhur në përfundimin se, edhe pse është arritur progres, kushtet për organizimin e zgjedhjeve të besueshme akoma nuk janë krijuar. Po të njëjtën ditë, parlamenti miratoi kërkesën e BDI-së për të shtyrë shpërbërjen e parlamentit deri më 7 prill.

Një ditë përpara shpërbërjes së parlamentit, LSDM paralajmëroi qëllimin e saj për tërheqjen e përfaqësuesve të tyre nga qeveria e përkohshme. Megjithatë, kjo çështje nuk hyri në agjendën e parlamentit.<sup>4</sup> Më 7 prill parlamenti u shpërnda, kurse më 15 prill, kryetari i parlamentit shpalli zgjedhje për 5 qershor. LSDM, së bashku me 13 parti nënshkroi një Platformë për Maqedoni Demokratike, duke ftuar për zbatimin e Marrëveshjes së Përzghinos dhe paralajmëroi bojkotimin e këtyre zgjedhjeve.<sup>5</sup>

Klima politike u përkeqësua pas 12 prillit, kur presidenti Gjorgje Ivanov solli vendimin për faljen e gjerë të gjithë individëve që janë dënuar, janë nën hetime ose të dyshuar për përfshirje në skandalin e përgjimeve.<sup>6</sup> Gjithë partitë e mëdha politike dënuan dhe ftuan presidentin për të revokuar vendimin e tij. Falja nxiti protesta dhe kundër-protesta, disa nga të cilat ishin të dhunshme.<sup>7</sup> Këto ngjarje të fundit kanë acaruar edhe më tepër gjendjen e tensionuar dhe të pasigurt dhe kanë shtuar këmbimin e retorikës së ashpër midis gjithë partive, e sidomos midis VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së.

#### IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet rregullohen me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor, plotësuar me rregullat e dekretuara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ).<sup>8</sup> Kodi Zgjedhor u miratua në vitin 2006, por kaloi nëpër një sërë ndryshimesh që atëherë. Si rezultat i Marrëveshjes së Përzghinos, u themelua një Grup Pune, me pjesëmarrje të VMRO-DPMNE-së, LSDM-së, BDI-së dhe PDSH-së. Grupi arriti një konsensus mbi reformat zgjedhore në nëntor të vitit 2015, ndërsa më 9 nëntor parlamenti miratoi një numër të konsiderueshëm ndryshimesh.<sup>9</sup>

Ndryshimet trajtuan shumicën e rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me parimin e barazisë së votës për votim nga jashtë vendit, përbërjen dhe kompetencat e KSHZ-së, barazinë në kuptimin e raportimit mediatik gjatë periudhës zgjedhore, fuqizimin e raportimit financiar dhe revizionimit të partive, duke përmirësuar garancitë për veçimin e partisë nga shteti, aplikimin e afateve brenda të cilave gjykatat do të vendosin rreth kontesteve zgjedhore, si dhe qartësimin e përkufizimit të zbatimit të fushatës dhe të periudhës së fushatës.

Përderisa ndryshimet paraqesin përpjekje për përmirësim të Kodit Zgjedhor, shumë bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë theksuar se zbatimi i plotë i Kodit ka rëndësi të njëjtë. Ata gjithashtu kanë shprehur mendimin se ndryshimet e vonuara mund të kenë efekt

<sup>4</sup> Sipas rregullave të parlamentit, dorëheqjet e qeverisë duhet vënë në agjendën e seancës së rradhës.

<sup>5</sup> Veç kësaj, janë shtatë parti tjera që paralajmëruan bojkot, por nuk kanë nënshkruar platformën

<sup>6</sup> Gjithsej 56 persona janë falur, duke përfshirë këtu liderët e VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, ish zyrtarë qeveritarë, politikanë, anëtarë të stafit të Prokurorisë Speciale dhe disa biznesmenë.

<sup>7</sup> Gjatë demonstratave të 13-14 prillit, 6 persona kanë pësuar lëndime, kurse shumë godina, në mesin e të cilave dhe Zyra e Informimit të Presidentit, janë dëmtuar. Demonstratat pasuese kanë qenë shumë më të qeta.

<sup>8</sup> Korniza ligjore gjithashtu përfshin dhe Ligjin mbi Partitë Politike, Ligjin mbi Financimin e Partive Politike, Kodin Penal, Ligjin mbi Mediat dhe Ligjin mbi Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

<sup>9</sup> U miratua nisma me 104 nga gjithsej 123 vota (108 anëtarë të parlamentit kanë qenë të pranishëm gjatë votimit).

negativ mbi kuptimin e palëve të përfshira në zgjedhjet të dispozitive të reja dhe mund të ndikojnë mbi aftësinë e tyre për t'i përmbushur detyrat e tyre.<sup>10</sup>

120 deri 123 deputetë zgjedhen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional, duke përdorur lista të mbyllura. Nga ata, 20 deputetë zgjedhën në secilën njësi zgjedhore në vend, me një numër të ngjashëm të votuesve.<sup>11</sup> Si rezultat i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor që u bënë në vitin 2015, deri në 3 deputetë mund të zgjedhën nga një njësi e vetme jashtë vendit.<sup>12</sup>

## V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet administrohen nga KSHZ, 80 Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe diku 3,500 Këshilla Zgjedhore (KZ), duke përfshirë dhe 53 këshillat jashtë vendit. Si pasojë e Marrëveshjes së Përzghinos, përbërja e KSHZ-së është rritur nga shtatë në nëntë anëtarë, duke përfshirë këtu dhe tre ekspertët e pavarur, të zgjedhur nga parlamenti gjatë një procesi të hapur të rekrutimit. Koalicionet e partive në pushtet dhe ato në opozitë në parlament dërguan nga 3 anëtarë shtesë. KSHZ e re u emërua nga parlamenti më 16 dhjetor të vitit 2015, që ishte pesë muaj më vonë se si ishte përcaktuar me Marrëveshjen e Përzghinos. Kryetari i KSHZ-së dhe zëvendësi i tij u zgjedhën nga anëtarët jopartiak.

KKZ-të përbëhen nga pesë anëtarë të cilët KSHZ zgjedh me zgjedhje të rastit nga mesi i punonjësve në administratën shtetërore dhe komunale. Pasi që mandati i KKZ-ve përfundon më 28 prill, KSHZ duhet emëruar KKZ të reja deri më këtë datë. KZ përbëhen nga pesë anëtarë – tre zgjedhën me zgjedhje të rastit nga stafi publik dhe nga dy të emëruar nga partitë kryesore në pushtet dhe në opozitë. Parashtruesi i listës së kandidatëve gëzon të drejtën të emërojë nga një vëzhgues për secilin organ të administratës zgjedhore.

Kodi Zgjedhor përcakton përfaqësim të drejtë të grupeve etnike dhe të gjinive në organet e administratës zgjedhore. Nga nëntë anëtarët e KSHZ-së, dy janë gra dhe tre janë Shqiptarë etnikë. Përderisa sipas ligjit, të gjitha seancat duhet qenë publike, KSHZ ka mbajtur dhe takime pune të mbyllura për mediat dhe vëzhguesit.

KSHZ vepron në një ambient të tensionuar politik dhe seancat e tij të gjata tërheqin vëmendjen e mediave. Më 15 prill, pas një diskutimi midis KSHZ dhe ambasadorët e BE-së dhe SHBA-ve, KSHZ publikisht shqyrtoi dhe votoi me gjashtë vota për se ishin të përgatitur për zbatim të “zgjedhjeve të ndershme dhe demokratike”. Kryetari i KSHZ-së dhe dy përfaqësuesit e LSDM-së refuzuan të votojnë dhe braktisën takimin.

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtën e votimit, përveç nëse nuk u është marrë aftësia e punës, me vendim gjyqësor. Regjistrimi i votuesve është pasiv, me përjashtim të votuesve

<sup>10</sup> Kapitulli II.2.b i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) të vitit 2002 të Këshillit të Komisionit të Evropës për Demokraci nëpërmjet të Ligjit (Komisioni i Venedikut) rekomandon që “elementet bazë të Ligjit mbi Zgjedhjet... nuk duhet t’u nënshtrohen ndryshimeve për më pak se një vit përpara mbajtjes së zgjedhjeve”. Megjithatë, rekomandimet pasuese konsiderohen të jenë përjashtim i parimit të stabilitetit të Ligjit mbi Zgjedhjet.

<sup>11</sup> Ligji lejon devijime deri në pesë për qind nga numri mesatar i votuesve për njësi zgjedhore.

<sup>12</sup> Që të zgjedhet, kandidati i parë patjetër duhet marrë numrin e njëjtë të votave si deputeti i zgjedhur me numrin më të ulët të votave nga një njësi zgjedhore brenda vendit; që të zgjidhet kandidati i dytë, duhet marrë dyfish më tepër vota, kurse zgjedhja e kandidatit të tretë kërkon trefish më tepër vota. Nëse nuk arrihet pragu përkatës, nuk do të zgjedhet asnjë nga kandidatët.

që përkohësisht qëndrojnë jashtë vendit dhe të cilët duhet aktivisht të regjistrohen. Të drejtat e votimit u jepen personave me vendbanim të regjistruar në vend, të cilët posedojnë letërnjoftim ose pasaportë biometrike.

Saktësia e listës zgjedhore mbetet të jetë njëra nga çështjet më të diskutueshme në krizën aktuale politike. Pas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në vitin 2015, KSHZ mban përgjegjësinë për mbajtjen e listës zgjedhore, duke u bazuar mbi të dhënat e nxjerra nga regjistrat civil dhe të popullatës. Në shkurt, KSHZ filloi pastrimin e listës zgjedhore, me kontrollat e kryqëzuara të bazave të të dhënave nga 11 institucione shtetërore, si dhe me bërjen e verifikimeve në terren.<sup>13</sup> Bashkëbiseduesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it theksuan se procesi kishte dëshmuar se është i ndërlikuar, sfidues për nga metodologjia, si dhe kërkon resurse të shumta.

Nga gjithsej 1.8 milionë votues, janë identifikuar rreth 330,000 votues të cilët kishin nevojë për qartësimin e statusit të tyre. KSHZ kishte gjuarmuar paqëndrueshmëri në bazat e të dhënave dhe në të dhënat e analizuara të cilat do të kishin mund të tregojnë për paqartësi të mundshme, siç janë personat e vdekur që ende mbeten në listat, numri i madh i votuesve të regjistruar në një adresë të vetme, ose votuesit me emra dhe data të njëjta të lindjes. Rreth 220,000 evidenca janë dërguar për qartësime plotësuese në MPB dhe në disa institucione tjera shtetërore.

KSHZ publikoi një listë me rreth 89,000 qytetarë, të dhënat e regjistrimit e të cilëve duhej të konfirmohej gjatë vizitave të terrenit në vendbanimet e votuesve midis 28 marsit dhe 5 prillit. Pas një intervenimi të bërë nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale më 30 mars, KSHZ largoi këtë listë nga ueb faqja e tij, së bashku me listën kombëtare me adresat e votuesve.<sup>14</sup>

Mbi 550 përfaqësues të KSHZ-së vizituan shtëpitë e rreth 87,000 votuesve, duke plotësuar pyetësorë të cilët më vonë janë azhurnuar në bazën e të dhënave të KSHZ-së.<sup>15</sup> Rreth 35,000 votues janë takuar personalisht, ndërsa 41,000 nuk kanë qenë të pranishëm, por të dhënat e tyre prapëseprapë janë kontrolluar. Mbi 10,000 formularë nuk kanë treguar nëse votuesi është takuar personalisht, ose jo. KSHZ largoi rreth 1,100 persona të vdekur nga lista zgjedhore dhe për momentin është në pritje të përgjigjes nga MPB lidhur me mijëra evidenca tjera.

Pastrimi i listës zgjedhore do të vazhdojë dhe në periudhën zgjedhore. Listat zgjedhore pritet të dërgohen për shqyrtim publik nga 25 prilli dhe partitë politike do të mund të kundërshtojnë cilëndo evidencë. Për herë të parë gjatë këtyre zgjedhjeve, në ditën e zgjedhjeve do të vendosen fotografitë e votuesve në listat zgjedhore.

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATIT

Secili votues me të drejtë vote mund të jetë kandidat, përveç atyre që kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor me burgim për më tepër se gjashtë muaj dhe të cilët ende nuk kanë vuajtur

---

<sup>13</sup> Janë këto: MPB, Regjistri Qendror, Drejtoria e Regjistrat Civil, Fondi i Sigurimit Shëndetësor, Agjencia e Punësimit, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Kadastra e Patundshmërive, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Banka Popullore, Zyra e të Hyrave Publike.

<sup>14</sup> Neni 31 (28-d) i Kodit Zgjedhor obligon KSHZ-në të publikojë listat zgjedhore në faqen e tij, duke përfshirë emrat, mbiemrat dhe adresat e votuesve. Lista me 89,000 votues përfshinte informacione mbi gjininë dhe datën e lindjes. Lista kombëtare mundësonte që votuesi të kontrollonte gjithë banorët e regjistruar në cilëndo adresë.

<sup>15</sup> 2,000 votuesit tjerë nuk kanë patur asnjë adresë në bazat e të dhënave.

dënimin e tyre. Ligji gjithashtu identifikon një sërë pozitash qeveritare dhe që lidhen me qeverinë, të cilat nuk përputhen me kandidaturën.

Kandidatët mund të emërohen nga partitë politike, koalicionet e partive politike, ose nga grupe të votuesve. Listat e kandidatëve që dërgohen nga grupe votuesish duhet përmbajtur të paktën 1,000 nënshkrime mbështetëse të votuesve që banojnë në njësitë përkatëse. Në pajtim me rekomandimin paraprak të OSBE/ODIHR-it, tani votuesi mund të nënshkruajë për mbështetjen e më tepër se një garuesi të mundshëm, por megjithatë, duhet grumbulluar nënshkrimet përpara një përfaqësuesi rajonal të KSHZ-së.<sup>16</sup>

Listat e kandidatëve duhet të dërgohen në KSHZ më së voni deri më 11 maj, që të përfundohet procesi i regjistrimit të kandidatit më së voni deri më 13 maj. Gjatë një përpjekjeje për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave, Kodi Zgjedhor tanimë përcakton se të paktën 40 për qind të kandidatëve duhet t'i takojnë gjinisë më pak të përfaqësuar.<sup>17</sup>

### VIII. FUSHATA DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Fushata zyrtare zgjedhore do të fillojë më 16 maj, dhe do të përfundojë 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Sipas rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it, shfrytëzimi i resurseve administrative për zbatim të fushatës, duke përfshirë këtu shfrytëzimin e hapësirave të zyrës, pajisjes së zyrës dhe automjeteve zyrtare, janë rreptësisht të ndaluara. Kodi tani ndalon dhe bërjen e presionit ose frikësimin e votuesve dhe detyron gjithë garuesit zgjedhor të firmosin Kodin mbi Zgjedhjet e Ndershme dhe Demokratike si garanci.

Shpallja falas e afisheve të fushatës lejohet vetëm në zonat që do të përcaktohen nga secila komunë.<sup>18</sup> Afishet mund të shpallen në godina private vetëm me pëlqimin e pronarit. Përderisa shumica e formave të zbatimit të fushatës nuk lejohen para 16 majit, reklamimi politik në stendat e afishimit dhe panelet reklamuese është i lejuar. Partitë politike kanë të drejtën e marrjes me qira të paneleve reklamuese dhe stendave të afishimit në mënyrë transparente.<sup>19</sup>

Kodi Zgjedhor rregullon financimin e fushatave zgjedhore. Gjithë donacionet dhe shpenzimet që lidhen me fushatën duhet të bëhen nëpërmjet të një xhiro-llogarie. Personat privat me aftësi veprimi juridik lejohen të dhurojnë deri në kundërvlerën e 3,000 eurove në denarë të Maqedonisë, ndërsa personat juridik mund të dhurojnë deri në 30,000 euro. Donacionet e huaja ose anonime, si dhe ato nga organizatat shtetërore, fetare dhe bamirëse janë të ndaluara. Zbritjet që do t'u ofrohen pjesëmarrësve në fushatë nga shtëpitë mediatike do të konsiderohen si donacione. Secili garues zgjedhor nuk mund të shpenzojë më tepër se 1.80 euro (110 denarë) për votues të regjistruar në njësinë zgjedhore në fjalë.

Garuesi zgjedhor duhet të dërgojë dy raporte të përkohshme dhe raportin përfundimtar financiar. Në përputhje me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-it, tani kërkohet raportimi i

---

<sup>16</sup> OSBE/ODIHR paraprakisht ka rekomanduar të mendohet rreth metodave alternative për marrjen e nënshkrimeve për të dobësuar potencialin për frikësim.

<sup>17</sup> Kjo paraqet rritje të kuotës për 10 për qind, në krahasim me zgjedhjet e vitit 2014. Çdo kandidat i tretë dhe i dhjetë duhet qenë nga gjinia më pak e përfaqësuar.

<sup>18</sup> Komunat duhet të identifikojnë zonat 45 ditë para ditës së zgjedhjeve.

<sup>19</sup> Kodi Zgjedhor përcakton hapësirën për stendën e afishimit: 40 për qind për partitë në pushtet dhe për partitë në opozitë; dhe nga 10 për qind për partitë parlamentare pa grupe parlamentare dhe për partitë jashtë-parlamentare.

specifikuar i shpenzimeve financiare. Mbikëqyrja e financave të fushatës parimisht zbatohet nga Enti Shtetëror për Revizion.

## IX. MEDIAT

Mediat që përbëhen nga një numër i madh i shtëpive mediatike dhe televizionit mbeten të jenë burimi mbizotërues i lajmeve dhe informacioneve. Bashkëbiseduesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë shprehur shqetësime lidhur me përqëndrimin e lirisë së mediave për arsye të presionit politik dhe ndërhyrjes së pronarëve në punën e gazetarëve. Ata gjithashtu kanë nënvizuar nevojën për reforma thelbësore.<sup>20</sup> Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave gjithashtu ka ftuar autoritetet që “të zbusin presionin mbi mediat dhe të respektojnë shprehjet e lira dhe kritike”.<sup>21</sup>

Kushtetuta, Ligji mbi Mediat dhe Ligji mbi Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale formojnë kornizën ligjore të mediave, që kërkon trajtim të barabartë të partive politike. Veç kësaj, Kodi i ndryshuar Zgjedhor obligon mediat elektronike të raportojnë mbi zgjedhjet në mënyrë të ndershme, të balancuar dhe të paanshme, duke u ofruar garuesve qasje të drejtë. Gjithashtu po aplikohen dhe rregullat e rrepta që drejtojnë përfshirjen e lajmeve dhe raportimin mbi aktivitetet e rregullta dhe institucionet komunale gjatë fushatës. Si pjesë e Marrëveshjes së Përzahos, janë mbajtur këshillime midis katër partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile për të avancuar reformat në shtrirjen mediatike, por megjithatë, ndryshimet që u propozuan nga organizatat e shoqërisë civile janë hedhur poshtë nga parlamenti më 4 prill.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA), mediat elektronike dhe autoriteti rregullues, duhet të zbatojë monitorimin e mediave elektronike dhe ato të internetit gjatë periudhës zgjedhore. Për shkak të mungesës së përkufizimit të qartë të ueb portaleve në Kodin Zgjedhor, ASHMAA nuk ka për qëllim të monitorojë mediat e tilla. Përderisa gjatë periudhës para fushatës ASHMAA monitoron vetëm mediat elektronike dhe kontrollon shtëpitë mediatike rajonale dhe lokale vetëm në raste të ankesave, ajo do të monitorojë gjithë mediat elektronike pas fillimit të fushatës.

Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë (KEMM), që vepron nga fillimi i vitit 2015, është një organ vetë-rregullues, i cili shqyrton ankesat që kanë të bëjnë me përmbajtjen në media. Më 12 shkurt, shumica e mediave private kanë nënshkruar “Kartën për Raportim Etik gjatë Zgjedhjeve” të KEMM-it, duke u zotuar për raportim të balancuar, të besueshëm, të paanshëm dhe objektiv. Më herët në janar, edhe transmetuesi publik Radio dhe Televizioni i Maqedonisë (RTM) miratoi “Parimet Etike dhe Profesionale të RTM-së për Përfshirje Mediatike të Procesit Zgjedhor”, me të cilin vendosen udhëzimet e përgjithshme për gazetarët në kuptimin e raportimit mbi zgjedhjet.

Më 7 prill, MVZ i OSCE/ODIHR-it filloi monitorimin kualitativ dhe kuantitativ të tetë kanaleve televizive dhe pesë gazetave ditore.<sup>22</sup>

<sup>20</sup> Vendi konsiderueshëm ka rënë nga pozita 34 në vitin 2009 deri në pozitën 117 në vitin 2015 në [Indeksin Botëror të Lirisë së Mediave të përgatitur nga Raportuesit pa Kufij](#).

<sup>21</sup> Shihni [Komunikatën për Shtyp](#) të Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave të 17 janarit të vitit 2015.

<sup>22</sup> Kjo përfshin RTM-1 dhe RTM-2, TV-të private *Sitel*, *Kanal 5*, *Alfa*, *Telma* dhe *Alsat-M* gjatë kohës së shikueshmërisë më të lartë (nga ora 18:00 deri në ora 24:00), si dhe si programe të lajmeve qendrore në *Vesti 24* (nga ora 20:00 deri në 22:00). Gazetat ditore janë: *Dnevnik*, *Vest*, *Sloboden Pecat*, *Koha* dhe *Lajm*.

## **X. ANKESAT DHE PADITË**

Ankesat lidhur me zgjedhjet mund të parashtrohen nga përfaqësues të autorizuar të kandidatëve, nga parashtruesit e listave të kandidatëve, si dhe nga votuesit. Ankesat shqyrtohen nga KSHZ, dhe për vendimet e tij mund të dërgohen ankesa në Gjykatën Administrative.<sup>23</sup> Vendimet e Gjykatës Administrative janë përfundimtare.

Pas rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it, ndryshimet në Kodin Zgjedhor të vitit 2015 kanë përshtatur afatet e fundit për shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Ndërkaq, gjithë seancat dëgjimore duhet qenë të hapura për publikun. Vendimet lidhur me ankesat duhet të publikohen në ueb faqet e Gjykatës Administrative dhe të KSHZ-së. Deri më tani nuk është parashtruar asnjë ankesë në KSHZ dhe në Gjykatën Administrative.

Në pajtim me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-it, KSHZ ka themeluar repartin juridik për shqyrtimin e ankesave. Ndërkaq, Kodi Zgjedhor fton për themelimin e një sistemi për drejtimin e rasteve dhe ankesave, i cili duhet të futet në përdorim.

## **XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE**

Marrëdhëniet ndëretnike mbeten të jenë një faktor relevant në politikën e vendit dhe partitë politike priren kryesisht për t'iu qasur komuniteteve të tyre. Tradicionalisht, partitë që përfaqësojnë komunitetin shqiptar garuan veçmas, ndërsa partitë që përfaqësojnë komunitetet më të vogla janë rreshtuar me forcat më të fuqishme politike në koalicione parazgjedhore. Këto komunitete më të vogla i kanë shfaqur brengosje MVZ-së të OSBE/ODIHR-it për atë se nuk janë përfshirë në negociatat mbi Marrëveshjen e Përzahinos. Ata gjithashtu kanë pretenduar se partitë që përfaqësojnë komunitetet më të mëdha shfrytëzojnë resurset administrative dhe punësimet publike për të siguruar mbështetjen e pakicave.

Pas shpërbërjes së parlamentit, VMRO-DPMNE filloi formimin e koalicionit, duke përfshirë kështu disa parti që përfaqësojnë pakicat. Disa parti tjera të këtij lloji i kanë treguar MVZ-së të OSBE/ODIHR-it se nuk ekzistojnë kushte për zgjedhje të besueshme, dhe si të tilla, ata nuk dëshirojnë të marrin pjesë.

Kodi Zgjedhor përcakton të drejta të posaçme për pakicat. Në komunat ku komunitetet etnike përbëjnë të paktën 20 për qind të popullatës, ata duhet të jenë të përfaqësuar në KKZ-të dhe KZ-të, si dhe gjithë formularët dhe materialet zgjedhore, duke përfshirë këtu dhe fletëvotimet, duhet të përkthehen dhe në gjuhën e tyre. Në njësitë ku të paktën 20 për qind të qytetarëve flasin njëri nga gjashtë gjuhët e pranuar zyrtarisht, listat e kandidatëve mund të parashtrohen dhe në këtë gjuhë.

## **XII. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË**

Kodi Zgjedhor përcakton vëzhgime të zgjedhjeve nga vëzhgues ndërkombëtarë, si dhe nga vëzhgues qytetarë. Organizatat qytetare për vëzhgim MOST dhe CIVIL kanë shpallur qëllimin e tyre për t'i vëzhguar këto zgjedhje. Në këtë fazë, MOST ka 80 vëzhgues në 18 zyra rajonale,

---

<sup>23</sup>

Si përjashtim, gjykata themelore kompetente dëgjon ankesat lidhur me çfarëdo parandalimi ose shqetësimi të fushatës. KKZ-të nuk kanë jurisdikcion mbi ankesat zgjedhore.



ndërsa CIVIL ka 35 vëzhgues në 14 zyra rajonale, si dhe 12 vëzhgues në lëvizje. Më 5 prill, Policia Financiare ka filluar hetime për MOST-in lidhur me pagesa jashtë vendit të konsulentëve të huaj dhe disa bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë vënë në pyetje kohën e zbatimit të investigimit të tillë.

### **XIII. AKTIVITETET E MISIONIT**

MVZ i OSBE/ODIHR-it filloi punën e tij në Shkup më 31 mars. Shefi i Misionit u takua me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, të partive politike, të Misionit të OSBE-së në Shkup, si dhe me përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar.<sup>24</sup> MVZ themeloi kontakte me palët e përfshira në zgjedhje në të gjitha nivelet. Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP OSBE) dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) kanë për qëllim të dërgojnë delegacione për vëzhgim në ditën e zgjedhjeve.

*Versioni në gjuhën anglishte i këtij Raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Përkthim jozyrtar është siguruar në gjuhën maqedonishte dhe shqipe.*

---

<sup>24</sup> [MVZ i OSBE/ODIHR](#) dhe [Misioni i OSBE-së në Shkup](#) veprojnë veçmas secili në kuadër të mandatit të vet konkret.